

Datë: 08.09.2025

INFORMACION MBI PALET**KREDIDHËNËS**

Emri i Shoqërisë: ECFA Sh.a

Numri i Regjistrimit: L71610009A

Selia: Rruga "Muhamet Gjollësja", Ndertesa Tirana Ring Center, Nr. 8, Kati i 9-te, Tirane, Albania Adresa e-mail:

info@kredo.al Telefon: +355 44 500 600 Vendi i ofrimit: Rr:

Kristaq Rama perballe Stacionit te Trenit,-,-
, Durres**KREDIMARRËS Emër, mbiemër:**

Emri i babait:

Numri personal i identifikimit:

Letërnjoftimi/Pasaporta:

Adresa:

Adresa e-mail:

Telefon: +(355)

PËRCAKTIMET DHE TERMAT**1. Përcaktimet dhe Termat**

1.1 Termat e përcaktuara në vijim, si dhe termat e përcaktuara diku tjetër në këtë Marrëveshje, do të përdoren në këtë Marrëveshje sipas kuptimit përkatës:

1.1.1 Kredimarrësi: do të thotë individ ose personi fizik i identifikuar si e tillë në hyrjen e kësaj Marrëveshje.

1.1.2 Llogaria Bankare e Kredimarrësit: do të thotë llogaria bankare e Kredimarrësit e deklaruar nga ai gjatë procesit të aplikimit për kredi, siç mund të ndryshohet nga Kredimarrësi nëpërmjet një Njoftimi sipas Nenit 12, apo çdo llogari tjetër bankare nga e cila Kredimarrësi ka kryer pagesa për Kredidhënesin.

1.1.3 Kontaktet e Kredimarrësit: do të thotë adresa e e-mailit dhe/ose numri i celularit/telefonit të Kredimarrësit, shënuar më sipër në hyrje të kësaj Marrëveshje, siç mund të ndryshohet nga Kredimarrësi nëpërmjet një Njoftimi sipas Nenit 12, tek të cilat Kredimarrësi pranon të kontaktohet dhe të marrë Njoftime dhe komunikime nga Kredidhënesi.

1.1.4 Degët: janë ambientet e Kredidhënesit dhe/ose të partnerëve të autorizuar prej tij, nëpërmjet të cilave Kredidhënesi ushtron aktivitetin; një listë e plotë e Degëve gjendet në Faqen e Internetit të Kredidhënesit <http://www.kredo.al>.

1.1.5 Ditë Pune: do të thotë çdo ditë e javës përveç ditëve të festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Oraret e punës janë të shpallura në faqen zyrtare <https://www.kredo.al/deget> dhe në çdo degë.

1.1.6 Kostot dhe interesat: janë komisionet, interesat dhe kostot e tjera të shënuara në Tabelën e Kostove dhe Interesave të Kredidhënesit (përcaktuar si vijon), që Kredimarrësi detyrohet t'i paguajë Kredidhënesit në lidhje me këtë Marrëveshje.

1.1.7 Marrëveshje: është kjo Marrëveshje Linjë Kredie, lidhur mes Kredimarrësit dhe Kredidhënesit.

1.1.8 Mosmarrëveshjet: janë mosmarrëveshjet e përcaktuara sipas Nenit 14 të kësaj Marrëveshje.

1.1.9 Lëvrime: është çdo shumë që Kredidhënesi i disburson Kredimarrësit sipas kësaj Marrëveshje, mbi bazën e një Aplikimi për Disbursim të paraqitur nga Kredimarrësi.

1.1.10.1 Afati i marrëveshjes: është afati i kësaj Marrëveshje, përcaktuar sipas Nenit 4 në vijim.

1.1.10.2 Afati i kredisë: është afati i kredisë që përfitohet nën këtë marrëveshje për linjë kredie

1.1.11 Rast Mospërmbushje: janë rrethanat e përcaktuara sipas Nenit 13 të kësaj Marrëveshje.

1.1.12 Interesi: Norma nominale e interesit për shlyerjen e kredisë paraqitet si % vjetore e pandryshueshme në vit, llogaritur mbi principalin e mbetur.

1.1.13 Norma e Interesit: do të thotë norma në përqindje mbi Shumën e Kredisë së mbetur, që Kredimarrësi detyrohet t'i paguajë Kredidhënesit si Interes; Norma e Interesit përcaktohet dhe llogaritet sipas kushteve dhe afateve të Tabelës së Kostos dhe Interesit të Kredidhënesit (përcaktuar si vijon), siç është në fuqi në momentin e zbatimit dhe e përcaktuar në çdo përditësim të Aneksit 1.

1.1.14 Norma Efektive e Interesit: Norma Efektive e Interesit është totali i kostos së kredisë për klientin e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë. Në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes dhe çdo përditësimi të Aneks 1, norma efektive e interesit paraqitet si NEI në %.

1.1.15 Kamatëvonesë: Kamatëvonesat në rastin e detyrimeve kontraktore (kësteve/principalit/interesit) që kryhen pasi u ka kaluar afati, siç janë të zbatueshme në kohën kur jepet ky informacion, si dhe penalitetet, të ndryshme nga kamatëvonesat, të cilat aplikohen në rast të mosrespektimit të kushteve dhe/ose afateve të tjera të kontratës, të cilat nuk janë përfshirë në llogaritjen e normës efektive të interesit por paguhen në rrethana të caktuara dhe përcaktuara në këtyre rrethanave. Në çdo rast kamatëvonesa e papaguar nuk tejkalon masën 30% të totalit të detyrimit kontraktuar të papaguar në vonesë.

1.1.16 Kredidhënesi: është shoqëria ECFA Sh.a- NUIS L71610009A.

1.1.17 Llogaria Bankare e Kredidhënesit: do të thotë çdo llogari bankare e publikuar nga Kredidhënesi në Faqen e Internetit të Kredidhënesit (përcaktuar si vijon), si dhe pranë Degëve.

1.1.18 Shuma e Kredisë: është shuma totale e të gjitha Disbursimeve të kryera nga Kredidhënesi, që në çdo moment kohor rezulton e pakthyer nga ana e Kredimarrësit.

1.1.19 Aplikim për Ndryshimin e Kushteve: është çdo kërkesë e shkruar sipas formatit të miratuar nga Kredidhënesi, që Kredimarrësi paraqet pranë Degëve, apo në mënyrë elektronike nëpërmjet Llogarisë Online, për ndryshimin e kushteve origjinale të një shume të Disbursuar. 1.1.20 Aplikim për Disbursim: është çdo kërkesë e shkruar sipas formatit të miratuar nga Kredidhënesi, që Kredimarrësi paraqet pranë Degëve, apo në mënyrë elektronike nëpërmjet Llogarisë Online, për disbursimin e një Shume Kredie, deri në vlerën e Limitit.

1.1.21 Komisioni i Shtyrjes së Kredisë: komisioni (-et) për shtyrjen e afatit të Datës së Pagesave.

1.1.22 Komisioni i angazhimit, është komision për angazhimin e fondeve të kredisë, për llogaritjet mbi vlerën e kredisë, i detyrueshëm për t'u paguar i plotë pavarësisht afatit të mbajtjes së kredisë. Ky komision në bazë të rregullores së Bankës së Shqipërisë nr 48 mbi Kredinë Konsumatore dhe Hipotekore, neni 15/1, është i pagueshëm në momentin e lëvrimit të kredisë, i parimbursueshëm në rast tërheqje nga kredia apo mbyllje paraafati dhe në rast se nuk paguhet nga klienti përpara disbursimit do të zbritet si pagesë nga vlera e kredisë së lëvruar.

1.1.23 Komisioni për lëvrimin e kredisë me para në dorë, është komisioni që paguhet në rastet kur Kredimarrësi zgjedh që kredia e tij të lëvrohet në kesh dhe jo me transfertë bankare. Për llogaritjet mbi vlerën e kredisë dhe është i detyrueshëm për t'u paguar i plotë pavarësisht afatit të mbajtjes së kredisë.

Ky komision ne baze te rregullores se Bankes se Shqiperise nr 48 mbi Kredine Konsumatore dhe Hipotekore, neni 15/1, eshte i pagueshem ne momentin e levrimit te kredise, i parimbursueshem ne rast terheqje nga kredia apo mbyllje para afati dhe ne rast se nuk paguhet nga klienti perpara disbursimit do te zbritet si pagese nga vlera e kredise se levruar.

1.1.24 Komisioni i levrimit te menjehershëm te kredisë, është komisioni që paguhet në rastet kur Kredimarrësi zgjedh që kredia e tij të lëvrohet menjëherë dhe jo sipas kohës standarde së përcaktuar në nenin 6.4 të kësaj marrëveshje. Përllogaritet mbi vlerën e kredisë së lëvruar dhe është i detyrueshëm për t'u paguar i plotë pavarësisht afatit të mbajtjes së kredisë. Ky komision ne baze te rregullores se Bankes se Shqiperise nr 48 mbi Kredine Konsumatore dhe Hipotekore, neni 15/1, eshte i pagueshem ne momentin e levrimit te kredise, i parimbursueshem ne rast terheqje nga kredia apo mbyllje paraafati dhe ne rast se nuk paguhet nga klienti perpara disbursimit do te zbritet si pagese nga vlera e kredise se levruar.

1.1.25 Komisioni për shërbimin e pagesave kesh, Kredimarrësi mund të zgjedhë të kryejë pagesat që lidhen me kredinë në një nga degët e ECFA Sh.a ose në bankë apo institucione të tjera te pagesave me të cilat ECFA Sh.a ka një marrëveshje bashkëpunimi. Në rast se kryerja e pagesave do të bëhet në degët e ECFA Sh.a, atëherë do të aplikohet komisioni për shërbimin e pagesave kesh sipas tabelës së Interesit dhe Komisioneve në fuqi. 1.1.26 Afati i shtyrjes së kredisë: afati (-et) i shtyrjes së Datës së Pagesave.

1.1.27 Limiti: do të thotë vlera totale e kredisë e miratuar nga Kredidhënësi, deri tek e cila Kredimarrësi lejohet të ketë si ekspozim në çdo moment kohor që rezulton e pakthyer nga ana e Kredimarrësit

1.1.28 Aplikim për Limit: është çdo kërkesë e shkruar sipas formatit të miratuar nga Kredidhënësi, që Kredimarrësi paraqet pranë Degëve, apo në mënyrë elektronike nëpërmjet Llogarisë Online, për rritjen e Limitit të miratuar më parë nga Kredidhënësi.

1.1.29 Njoftim është çdo njoftim apo komunikim mes Kredidhënësit dhe Kredimarrësit në lidhje me këtë Marrëveshje, sipas përcaktimeve të Nenit 12 të kësaj Marrëveshje.

1.1.30 Llogaria Online: do të thotë llogaria e klientit, përcaktuar sipas Nenit 10 të kësaj Marrëveshje.

1.1.31 Kushtet e Llogarisë Online: janë kushtet dhe afatet e miratuara nga Kredidhënësi, siç janë në fuqi në momentin e zbatimit, të cilat rregullojnë mbajtjen dhe operimin e Llogarisë Online; Kredidhënësi publikon në Faqen e Internetit (<https://www.kredo.al/faqet/kushtet-dhe-afatet>) një kopje të Kushteve të Llogarisë Online, në fuqi në çdo kohë, dhe çdo ndryshim i Kushteve të Llogarisë Online do t'i njoftohet Kredimarrësit për miratim nëpërmjet Llogarisë Online, sipas parashikimeve të Nenit 12 të kësaj Marrëveshje.

1.1.32 Tabela e Interesit dhe të Komisioneve të Kredidhënësit: është tabela e publikuar nga Kredidhënësi në faqen zyrtare <https://www.kredo.al/faqet/tarifat> ku detajohen kostot e kredisë që janë në fuqi.

1.1.33 Shumat e Pashlyera: do të thotë shumat e përgjithshme që Kredimarrësi detyrohet t'i paguajë Kredidhënësit sipas kësaj Marrëveshje, përbërë nga Shumat e Kredisë, Interesi dhe Komisionet e paguara në çdo moment kohor.

1.1.34 Pala ose Palët: janë Kredidhënësi dhe/ose Kredimarrësi, bashkërisht apo veçmas, sipas rastit.

1.1.35 Grafiku i Pagesave: do të thotë tabela me shumat dhe afatet e rrikthimit apo shlyerjes së çdo Shume Kredie, Interesi apo komisioni pranuar nga Kredimarrësi në bazë të një Aplikimi Disbursimi, siç mund të jetë ndryshe Kredia sipas një a më shumë Aplikimeve për Ndryshim të Kushteve, të miratuar nga Kredidhënësi, përcaktuar në çdo përditësim të Ankes

1.1.36 Data e Pagesave: është data në të cilën Kredimarrësi detyrohet të shlyejë një Shumë Kredie, apo të paguajë Interesin dhe/ose Komisionet, sipas Grafikut të Pagesave, apo afateve të tjera të parashikuara sipas kësaj Marrëveshje, specifikuar në çdo përditësim të Aneks 1.

1.1.37 Politika e Privatësisë: është dokumenti i miratuar nga Kredidhënësi, siç është në fuqi në momentin e zbatimit, që rregullon kushtet dhe afatet e mbledhjes dhe trajtimit të të dhënave personale të Kredimarrësit; Kredidhënësi publikon në Faqen e Internetit (<https://www.kredo.al/faqet/politika-e-privatesise>) një kopje të Politikës së Privatësisë, në fuqi në çdo kohë dhe çdo ndryshim i Politikës së Privatësisë do t'i njoftohet Kredimarrësit për miratim, nëpërmjet Llogarisë Online, sipas parashikimeve të Nenit 12 të kësaj Marrëveshje.

1.1.38 Njoftimi i Korrigjimit: është njoftimi i përcaktuar sipas Nenit 13 të kësaj Marrëveshje.

1.1.39 Tabela e Interesit dhe Komisioneve: është dokumenti i miratuar nga Kredidhënësi, siç është në fuqi në momentin e zbatimit, që përmban Normën e Interesit, Kamatëvonesën dhe Komisionet, si dhe mënyrat përkatëse të llogaritjes së tyre. Kredidhënësi publikon në Faqen e Internetit një kopje të Tabelës së Interesit dhe Komisioneve, në fuqi në çdo kohë dhe çdo ndryshim i Tabelës së Interesit dhe Komisioneve do t'i njoftohet Kredimarrësit për miratim, nëpërmjet Llogarisë Online, sipas parashikimeve të Nenit 12 të kësaj Marrëveshje.

1.1.40 Data e Nënshkrimit: do të thotë data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje si dhe çdo Aneks 1 nga Kredimarrësi dhe Kredidhënësi, siç është shënuar më sipër.

1.1.41 Njoftimi i Zgjidhjes: është njoftimi i përcaktuar sipas Nenit 13 të kësaj Marrëveshje.

1.1.42 Faqja e Internetit: është faqja në internet e Kredidhënësit, www.kredo.al.

1.1.43 Marrëveshje Kredi Konsumatore: Në perputhje me nenin 44 pika 3 të LIGJI NR.9902.DATË 17.04.2008 "PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE" të ndryshuar: Kredi konsumatore përkufizon vlerat që përfshijnë një shumë totale të kredisë më tepër se 30 mijë lekë ose më pak se 10 milionë lekë. Për shumën jashtë këtij përkufizimi, kontrata do të quhet thjesht "Marrëveshje Kredie" ku nuk gjejnë zbatim rregulloret përkatëse që lidhen me kredinë konsumatore. 2. Interpretimi

2.1 Kjo Marrëveshje, përveçse kur nga konteksti i dispozitës përkatëse rezulton ndryshe, do të interpretohet sipas parashikimeve vijuese:

2.1.1 Kur në këtë Marrëveshje i bëhet referencë ndonjë neni, seksioni, paragrafi, apo dokumenti tjetër, atëherë, përveçse kur nga konteksti rezulton ndryshe, kjo referencë do të jetë tek neni, seksioni apo paragrafi përkatës i kësaj Marrëveshje, apo tek dokumenti tjetër i cituar në këtë Marrëveshje, siç ky dokument është në fuqi në momentin e zbatimit.

2.1.2 Titujt e përdorur për nenet, paragrafët, nën-paragrafët, janë vetëm për lehtësi referimi në interpretimin e kësaj Marrëveshje dhe nuk do të çenojnë në asnjë mënyrë, kuptimin apo interpretimin e përmbajtjes së dispozitave përkatëse.

2.1.3 Sa herë që në këtë Marrëveshje përdoren fjalët "duke përfshirë", "përfshin", "në veçanti", "për shembull" e të tilla të ngjashme, këto fjalë do të kuptohen të ndjekura nga fjalët "pa u kufizuar vetëm në to".

2.1.4 Fjalët "këtu", "në këtë", "më poshtë" apo fjalë të ngjashme të përdorura në këtë Marrëveshje, përveçse kur nga konteksti rezulton ndryshe, do të kuptohen si referencë në këtë Marrëveshje në tërësi, dhe jo në ndonjë nen, seksion apo paragraf të veçantë të kësaj Marrëveshje.

2.1.5 Kur afati është caktuar me "ditë", këto do të jenë ditë kalendarike, përveçse kur parashikohen shprehimisht si Ditë Pune. Një afat prej një ose më shumë ditësh kalendarike ose Ditësh Pune do të nisë të llogaritet duke nisur nga dita kalendarike ose Dita e Punës e mëpasshme.

2.1.6 Kur afati është caktuar me "javë", "muaj" ose "vite", atëherë afati do të llogaritet nga data në datë ("data korresponduese"); kur afati është caktuar në "muaj", nëse muaji i fundit kalendari i periudhës përkatëse nuk ka një datë korresponduese të ditës së muajit kalendari në të cilën fillon afati, atëherë afati do të përfundojë në ditën e fundit kalendarike të muajit të fundit kalendari i periudhës.

2.1.7 Nënshkrim elektronik do të thotë vendosja e kodit të verifikimit që kredimarrësi merr me sms në numrin e telefonit i cili do të shërbejë si nënshkrim autentik i Kredimarrësit. Nëpërmjet vendosjes së këtij kodit verifikimi Kredimarrësi gjithashtu deklaron se është në dijeni të plotë dhe pranon parashikimet e Tabelës së Interesit dhe Komisioneve, Kushteve të Llogarisë Online dhe të Politikës së Privatësisë të Kredidhënësit.

2.1.8 Termat e përcaktuar në njëjës përfshijnë edhe shumësin, dhe anasjelltas.

3. Objekti dhe Qëllimi i Përdorimit të kredisë

3.1 Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, dhe sipas kushteve të saj, Kredidhënësi pranon t'i japë kredi Kredimarrësit, duke i miratuar një linjë kredie për përdorim konsumi personal deri në vlerën e Limitit, dhe Kredimarrësi pranon të marrë Kredi nga Kredidhënësi, herë pas here, dhe të kthejë shumën e marra Kredi, si dhe të paguajë Interesin dhe Komisionet sipas kushteve të rëna dakord në këtë Marrëveshje dhe çdo Aneks 1 të përditësuar.

4. Afati i marreveshjes

4.1 Kjo Marrëveshje lidhet dhe do të mbetet në fuqi për një afat të pacaktuar, duke nisur nga Data e Lidhjes ("Afati"), përveçse kur kjo Marrëveshje zgjidhet sipas parashikimeve të Nenit 13.

4.2 Nëse është e zbatueshme sipas ligjit në fuqi, Kredimarrësi ka të drejtë të tërhiqet nga kjo Marrëveshje, pa penalitete, dhe pa qenë i detyruar të deklarojë shkaqe, duke i dërguar Kredidhënësit një Njoftim me shkrim, jo më vonë se 14 (katërmëdhjetë) ditë nga Data e Lidhjes së kësaj Marrëveshje. E drejta e tërheqjes nga lëvrimi i një kredie tjetër apo shtesë të lëvruar në këtë marrëveshje, duhet ushtruar nga klienti jo më vonë se 14 (katërmëdhjetë) ditë nga Data e Lëvrimit të kredisë, ose shtesës, dhe nuk përbën një tërheqje nga e gjithë kjo marrëveshje për linjë kredie, por anulon efektin e Aneksit 1 përkatës të firmosur për atë kredi apo shtesë.

4.3 Me marrjen e Njoftimit mbi tërheqjen e Kredimarrësit, Kredidhënësi, nëpërmjet një Njoftimi me shkrim, do të informojë Kredimarrësin mbi shumatat që duhen kthyer nga Kredimarrësi (nëse ka), të cilat do të përfshijnë çdo shumë të disbursuar, Interesin e zbatuar gjatë ditëve përkatëse si dhe çdo kosto tjetër e shpenzimit e mundshme që Kredidhënësi ka hasur nga veprime me palë të treta, për efekt të miratimit dhe disbursimit të Kredisë (këto shumata do të përbëjnë pjesë të Shumave të Pashlyera të kësaj Marrëveshje).

4.4 Nëse Kredimarrësi nuk i paguan Kredidhënësit shumatat si më sipër, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditësh nga data e Data e Lidhjes së kësaj Marrëveshje, atëherë tërheqja e Kredimarrësit nga Marrëveshja nuk do të çënojë zbatueshmërinë e parashikimeve sipas Neneve 8, 9, 12, 14, 16, 17 dhe 18 të kësaj Marrëveshje, të cilat do t'i mbijetojnë tërheqjes së Kredimarrësit.

5. Limiti

5.1 Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, Kredidhënësi dhe Kredimarrësi hyjnë në një Marrëveshje kredie pa afat, brenda së cilës, Kredimarrësi mund të marrë me të njëjtat Përcaktime dhe Terma të kësaj Marrëveshje, disa kredi apo shtesa kredie sipas limitit të vlerës që përcaktohet nga Kredidhënësi për çdo kredi të re që Kredimarrësi merr, të specifikuar me terma dhe kushte në Aneksin 1 dhe 1.1 të kësaj Marrëveshje. Aneksi 1 dhe 1.1 konsiderohet pjesë e pandarë e kësaj marrëveshje kredie pa afat dhe përditësohet me termat përkatës sa herë Kredimarrësi merr një kredi të re apo shtesë kredie ekzistuese.

5.2 Kredimarrësi brenda kësaj Marrëveshje kredie pa afat, ka të drejtë të aplikojë për një kredi, ku për secilin aplikim për kredi të re i ofrohet një limit shumë i vlefshëm për një afat të pacaktuar. Nëse Kredimarrësi nuk dëshiron që ta marrë të plotë limitin e aprovuar, mund të marrë atë në disa shumata (pjesë). Në rast të një Aplikimi për Limit, Kredidhënësi ka të drejtë t'i kërkojë Kredimarrësit çdo informacion apo dokument që vlerëson të nevojshëm për analizën e kërkesës, me kusht që miratimi i çdo rritjeje të Limitit do të jetë në diskrecion të vetëm të Kredidhënësit. .

5.3 Kredidhënësi, me diskrecionin e tij të vetëm, ka të drejtë të ulë Limitin me efekt të menjëhershëm, nëse Kredimarrësi shkel detyrimet sipas kësaj Marrëveshje, apo rrezikon një zvogëlim/humbje të ndjeshme të të ardhurave të deklaruara prej tij/saj gjatë aplikimit për kredi, apo gjatë çdo analize kredie të mëpasshme të kryer nga Kredidhënësi. Kredidhënësi do t'i njoftojë me shkrim Kredimarrësit çdo vendim për ulje të Limitit.

5.4 Kredimarrësi ka të drejtë të paraqesë në çdo kohë një Aplikim për Limit, duke kërkuar rritjen e Limitit të miratuar më parë nga Kredidhënësi. Në rast të një Aplikimi për Limit, Kredidhënësi ka të drejtë t'i kërkojë Kredimarrësit çdo informacion apo dokument që vlerëson të nevojshëm për analizën e kërkesës, me kusht që miratimi i çdo rritjeje të Limitit do të jetë në diskrecion të vetëm të Kredidhënësit.

5.5 Pavarësisht ndonjë Aplikimi për Limit, Kredidhënësi, në diskrecion të vetëm, mund të rrisë Limitin e miratuar më parë, nëse Kredimarrësi ka një historik të mirë kreditimi me Kredidhënësin. Kredidhënësi do t'i njoftojë me shkrim Kredimarrësit çdo vendim për rritje të Limitit.

6. Disbursimet dhe Kthimi i Kredisë

6.1 Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje, Kredimarrësi ka të drejtë, herë pas here, me zgjedhjen e tij/saj të vetme, të paraqesë Aplikime Disbursimi, duke kërkuar lëvrimin e çdo shume, deri në vlerën e Limitit dhe çdo shumë e Disbursuar nga Kredidhënësi do të përbëjë një Shumë Kredie.

6.2 Për çdo Aplikim Disbursimi paraqitur sipas kësaj Marrëveshje, Kredimarrësi detyrohet të paguajë Komisionet përkatëse sipas Tabelës së Interesit dhe Komisioneve në fuqi në momentin e aplikimit.

6.2.1 Nëse aplikimi për disbursim kryhet përpara pagesës së plotë të një kredie ekzistuese me disa këste, atëherë shumata që do të disbursohet do të konsiderohet si një shtesë e kësaj kredie. Në rastin e një shtese kredie mbi kredinë ekzistuese, Interesi dhe Komisionet pjesë e Normes Efektive të Interesit (Komision angazhimi, Komision Administrimi) aplikohen sipas kushteve përkatëse në Tabelën e Kostos dhe Interesit në fuqi në datën e lëvrimit të kredisë ekzistuese sipas afatit të mbetur të kredise se ndryshuar. Nderkohe komisionet e tjera sipas shërbimeve / kërkesave të klientit, aplikohen mbi vlerën e shtesës së lëvruar sipas Tabelës në fuqi në momentin e shtesës së kredise.

6.3 Kredidhënësi rezervon të drejtën për të mos kryer Disbursimin, nëse Kredimarrësi njofton zgjedhjen e Marrëveshjes, shkel detyrimet sipas kësaj Marrëveshje apo rrezikon një zvogëlim/humbje të ndjeshme të të ardhurave të deklaruara prej tij/saj gjatë aplikimit për kredi, ose gjatë çdo analize kredie të mëpasshme të kryer nga Kredidhënësi. Kredidhënësi gjithashtu rezervon të drejtën për të mos kryer Disbursimin, nëse Kredimarrësi nuk ka pranuar versionin në fuqi të Tabelës së Interesit dhe Komisioneve, apo kredimarrësi nuk është paraqitur në degë ose pranë partnerëve për të tërhequr fondet brenda 7 ditëve nga data e miratimit të kredisë. .

6.4 Disbursimi do të bëhet në llogarinë bankare të Kredimarrësit, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve të punës pas nënshkrimit të Aneksit 1. Kredimarrësi mund të zgjedhë një mënyrë tjetër disbursimi edhe në para në degë, në sportelet e partnerëve të Kredidhënësit të publikuara në faqen zyrtare të internetit me koston e komisionit përkatës të publikuar në Tabelën e Interesit dhe Komisioneve. Kredimarrësi mund të zgjedhë gjithashtu lëvrimin e menjëhershëm pas firmosjes së marrëshjes dhe Aneksit 1 me koston e komisionit përkatës të publikuar në Tabelën e Interesave dhe Komisioneve.

6.5 Kredimarrësi ka të drejtën të tërhiqet nga marrëveshja dhe/ose Marrëveshja e kredisë konsumatore pa dhënë ndonjë arsye për këtë qëllim, brenda një periudhe kalendarike 14 (katërmëdhjetë) ditore. Ky afat fillon nga dita e arritjes së marrëveshjes ose lidhjes së Marrëveshjes, dhe njoftimi për tërheqjen duhet të kryhet me shkrim tek Kredidhënësi. Kjo e drejte do të perfitohej edhe në rastet e amendimeve , shtesave të kësaj Marrëveshjeje të aplikueshme e limituar për ato amendime dhe jo për të gjithë marrëveshjen e linjes së kredise.

6.6 ECFA Sh.a njofton Kredimarrësin në rastin e kërkesës me shkrim për tërheqjen e Marrëveshjes, për vlerën e kredisë, që duhet t'i rikthehet nga kredimarrësi përveç principalit të kredisë dhe kostot e përlllogaritura sipas termave dhe kushteve të interesit dhe komisioneve të ngarkuara në momentin e dhënies së kredisë, si dhe shpenzimet e mundshme të Kredidhënësit të krijuara nga veprime me palë të treta për efekt të disbursimit të kësaj Kredie.

6.7 Në vijim të një Disbursimi, Kredimarrësi do të kthejë Shumën e Kredisë në Datat e Pagesave përcaktuar në Grafikon e Pagesave të Aneksit 1.

6.8 Kredimarrësi ka të drejtë të paraqesë në çdo kohë një Aplikim për Ndryshimin e Kushteve, duke kërkuar ndryshimin e kësteve dhe Datës së Pagesave në lidhje me një Disbursim të mëparshëm.

6.9 Për çdo Aplikim për Ndryshimin e Kushteve paraqitur sipas kësaj Marrëveshje, Kredimarrësi detyrohet të paguajë Komisionet përkatëse përcaktuar sipas Tabelës së Interesit dhe Komisioneve në fuqi në momentin e aplikimit. Kredidhënësi rezervon të drejtën për të mos miratuar një Aplikim për Ndryshimin e Kushteve, nëse kredimarrësi nuk ka pranuar versionin në fuqi të Tabelës së Interesit dhe Komisioneve.

6.10 Kredidhënësi ka të drejtë t'i kërkojë Kredimarrësit çdo informacion apo dokument të vlerësuar të nevojshëm për analizën e Aplikimit për Ndryshimin e Kushteve dhe miratimi i çdo Aplikimi për Ndryshimin e Kushteve do të jetë në diskrecion të vetëm të Kredidhënësit.

6.11 Çdo Aplikim për Ndryshimin e Kushteve, i cili është miratuar nga Kredimarrësi, do të zëvendësojë Grafikon e Pagesave të Aneksit 1 për Disbursimin e kryer më parë.

6.12 Kredidhënësi do t'i njoftojë me shkrim Kredimarrësit miratimin e çdo Aplikimi Disbursimi dhe/ose Aplikimi për Ndryshimin e Kushteve.

6.13 Kredimarrësi mund ta shtyjë afatin e ripagimit të Kredisë deri në Afatin e Shtyrjes, ose të riprogramojë Grafikon e Pagesave të Aneksit 1 deri me një muaj në vijim, duke paguar Komisionin e Shtyrjes, duke pasur parasysh që shlyerja e pagesave të Marrëveshjes të mos vonohet me më shumë se 30 ditë, e nuk do të ketë tjetër shkelje të Marrëveshjes.

6.14 Afatet e Shtyrjes do të hyjnë në fuqi me marrjen e rregullt nga Kredidhënësi të pagesës së Komisionit të Shtyrjes.

6.15 Nëse shtyhet afati i shlyerjes së Kredisë, Kredimarrësi do t'i paguajë Kredidhënësit vetëm Komisionin e Shtyrjes gjatë Afatit të Shtyrjes, kurse shlyerja e pagesave të tjera të Marrëveshjes do të shtyhet.

7. Interesi dhe Komisionet

7.1 Norma nominale e interesit për shlyerjen e kredisë do të jetë e pandryshueshme në vit, llogaritur mbi kryegjënë e mbetur ashtu sic përcaktohet në Tabelën e Interesit dhe Komisioneve. 7.2 Normë efektive e interesit është totali i kostos së kredisë për klientin e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë llogaritur në kohën e nënshkrimit të Aneksit 1 dhe shpalosur në Aneksin 1. Kredimarrësi do t'i paguajë Kredidhënësit Interesin mbi Shumat e Kredise që rezultojnë të pakthyera, sipas Normës së Interesit të përcaktuar në Tabelën e Interesit dhe Komisioneve, në fuqi në momentin e Aplikimit për Disbursim, apo të Aplikimit për Ndryshim të Kushteve. Interesi do të llogaritet sipas mënyrave të parashikuara në Tabelën e Interesit dhe Komisioneve. Norma efektive e interesit ka të përcaktuar një normë maksimale sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë. Kjo normë maksimale ndryshon periodikisht dhe botohet në faqen e saj zyrtare të internetit.

Shembull:

Klienti tërheq kredi në vlerën 120000.00 ALL. Supozojmë që ai e mban të plotë 36 muaj këtë kredi dhe e paguan atë sipas grafikut të pagesës së marrëveshjes. Në këtë mënyrë, klienti do të paguajë për 36 muaj rresht një kësht prej 6430.00 ALL. Pra në total gjatë 36 muajve klienti paguan - Në formulën më poshtë "i" është NEI 120000.00 = 6430.00 ALL/((1+i)^(30/365)) + ... (36 herë).

Prandaj NEI shprehet në përqindje - 62.01.

7.3 Interesi do të paguhet nga Kredimarrësi në Datat e Pagesave, siç parashikohet nga Grafiku i Pagesave në Aneks 1.

7.4 Kredimarrësi detyrohet t'i paguajë gjithashtu Kredidhënësit komisionet sipas Tabelës së Interesit dhe Komisioneve, në fuqi në momentin kur zbatohet Komisioni dhe përveçse kur parashikohet ndryshe, çdo Komision duhet të paguhet nga Kredimarrësi përpara çdo aplikimi që mund t'i paraqitet Kredidhënësit.

8. Kamatëvonesat

8.1 Nëse Kredimarrësi nuk kthen Shumat e Kredisë, apo nuk paguan interesin, dhe/ose Komisionet e papaguara, ("Shumat e Pashlyera") sipas afateve të parashikuara në këtë Marrëveshje, atëherë Kredidhënësi ka të drejtë të zbatojë Kamatëvonesë, e përcaktuar dhe llogaritur sipas Tabelës së Interesit dhe Komisioneve, në fuqi në momentin e zbatimit. Kamatëvonesat paguhen nga kredimarrësi dhe nuk tejkalojnë në asnjë rast më shumë se 30 përqind të shumës së detyrimit kontraktor të kështit dhe/ose kësteve të papaguar të kredisë.

Shembull:

Supozojmë se për një kësht pagese kemi 1,000 ALL Principal + 50 ALL Interes. Në rast se ky kësht nuk paguhet në datën e përcaktuar në grafikun e pagesave, dhe pagesa rezulton me një ditë vonesë, kamatëvonesa për llogaritet: $1,060 * 2\% = 21.2$ ALL.

Në ditën e dytë, kjo kamatëvonesa do të jetë $21.2 * 2 = 42.4$ ALL, dhe me rritjen e ditëve të vonesës, kamatëvonesa rritet për çdo ditë vonese me vlerën 21.2 ALL, deri kur arrin maksimumin e saj të lejuar.

8.2 Zbatimi i Kamatëvonesës sipas parashikimeve të mësipërme nuk çënon të drejtën e Kredidhënësit për të nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm sipas Nenit 17, pa qenë i detyruar të zgjidhë Marrëveshjen, dhe/ose të zgjidhë Marrëveshjen sipas Nenit 13.

9. Kryerja e Pagesave

9.1 Çdo pagesë që Kredimarrësi detyrohet të kryejë ndaj Kredidhënësit sipas kësaj Marrëveshje, do të kryhet me para në dorë pranë Degëve, me transfertë pranë Llogarive Bankare të Kredidhënësit, apo pranë partnerëve të autorizuar rregullisht nga Kredidhënësi, të cilët janë të renditur tek Faqja

e Internetit, në monedhën e parashikuar për Shumën e Kredisë, Interesin dhe Komisioneve. Çdo pagesë që Kredimarrësi detyrohet të kryejë ndaj Kredidhënësit, do të konsiderohet e arkëtuar nga Kredidhënësi në momentin që fondet depozitohen pranë Degëve ose pranë partnerëve të autorizuar, apo kreditohen në Llogaritë Bankare të Kredidhënësit.

9.2 Kredimarrësi detyrohet të kryejë çdo pagesë ndaj Kredidhënësit sipas kësaj Marrëveshje, në shumë të plotë, pa kryer asnjë ulje, mbajtje apo kompensim dhe çdo kosto bankare që mund të lidhet me kryerjen e Disbursimeve, apo me pagesën e ndonjë shume që Kredimarrësi paguan sipas kësaj Marrëveshje, do të përballohet nga Kredimarrësi.

9.3 Kredimarrësi pranon se Kredidhënësi mund të mbajë, zbrësë apo kompensojë nga shuma e çdo Disbursimi/pagese, çdo shumë që Kredimarrësi i detyrohet Kredidhënësit sipas kësaj Marrëveshje. Kredimarrësi ka të drejtë të kryejë në çdo kohe edhe para afatit të maturimit shlyerje të pjesshme të detyrimeve të tij të lindura nga Marrëveshja e kredisë, duke njoftuar me shkrim. Në këtë rast Kredidhënësi do të bëjë reduktim të kostos totale të kredisë, duke ulur shumën e interesit dhe shpenzime të tjera të aplikueshme për shumën e kryegjësë së shlyer para afatit të maturimit.

9.4 Në rast të pagimit të plotë të detyrimeve përpara kohe, Kredidhënësi do të reduktojë koston totale të kredisë sipas kushteve rregullatore, por duke rezervuar të drejtën për të zbatuar komisionet e parapagimit që për llogariten mbi kryegjënë e mbetur, sipas Tabelës së Interesit dhe Komisioneve, në fuqi në momentin e parapagimit (për kredinë me disa këste: 0.5 % të shumës së kredisë së paguar para afatit, nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë nuk kalon 1 vit; dhe 1% të shumës së kredisë së paguar para afatit, nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është mbi 1 vit). Në çfarëdo rast parapagimi, siç përmendet këtu, Kredimarrësi duhet t'i dërgojë Kredidhënësit një Njoftim paraprak duke e informuar mbi parapagimin në fjalë dhe duke i kërkuar rilllogaritjen e Grafikut të Pagesave dhe koston totale të kredisë së përmendur këtu.

9.5 Të gjitha pagesat e marra nga Kredidhënësi dhe të kryera nga Kredimarrësi sipas përcaktimeve të kësaj Marrëveshje do të llogariten si vijon:

Në radhë të parë, për shlyerjen e shpenzimeve të kryera për mbledhjen e kredisë në vonesë;

Në radhë të dytë, për shlyerjen e kamatëvonesës;

Në radhë të tretë, për shlyerjen e të gjithë Komisioneve

Në radhë të katërt, për shlyerjen e Interesit;

Në radhë të pestë, për shlyerjen e Kryegjësë;

9.6 Në rast se pagesat që duhen kryer në favor të Kredidhënësit do të bëhen nga një palë e tretë e autorizuar nga Kredimarrësi, Kredimarrësi duhet të njoftojë rregullisht Kredidhënësin më parë se pala e tretë të kryejë pagesat që duhen bërë ndaj Kredidhënësit, nëpërmjet dërgimit të Njoftimit mbi sa përmendet këtu, duke dhënë informacion mbi palën e tretë, siç do të kërkohej nga Kredidhënësi. Kredidhënësi nuk ka detyrim të pranojë pagesat e kryera nga palë të treta të paidentifikuara të bëra për llogari të Kredimarrësit nëse Kredimarrësi nuk informon siç duhet Kredidhënësin mbi sa më lart.

9.7 Kredimarrësi ka të drejtë të marrë me kërkesën e tij dhe pa pagesë në çdo kohë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së kredisë gjendjen e llogarisë në formën e një plani shlyerje mbi shumën që ka shlyer e detyrimin e mbetur, e cila është në dispozicion të tij në çdo kohe pa pagese në profilin e tij online.

10. Llogaria Online

10.1 Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, Kredimarrësi pajiset dhe mban një llogari elektronike të klientit ("Llogaria Online") pranë Kredidhënësit, sipas kushteve dhe afateve të Llogarisë Online ("Kushtet e Llogarisë Online").

10.2 Llogaria Online do të jetë e aksesueshme elektronikisht nga Faqja e Internetit, sipas parashikimeve të Kushteve të Llogarisë Online.

10.3 Llogaria Online do të shërbejë si një platformë nëpërmjet së cilës Kredimarrësi do të menaxhojë marrëdhënien e tij me Kredidhënësin sipas kësaj Marrëveshje, çka përfshin, marrjen e informacionit mbi gjendjen e detyrimeve apo mbi transaksionet e kryera, kryerjen e ndryshimeve në të dhënat e Kredimarrësit, marrjen apo kryerjen e Njoftimeve për/nga Kredidhënësi, kryerjen e aplikimeve të ndryshme, etj. Llogaria Online nuk do të ketë funksionin e një sistemi pagese, për sa kohë që nuk përmbush kërkesat rregullatore të Bankës së Shqipërisë.

10.4 Të dhënat e Llogarisë Online do të trajtohen nga Kredidhënësi në përputhje me kushtet e zbatueshme të Politikës së Privatësisë.

11. Deklarimet dhe Garancitë e Kredimarrësit

11.1 Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, Kredimarrësi garanton dhe i deklaron Kredidhënësit, se:

11.1.1 Të gjitha informacionet / dokumentat e paraqitura nga Kredimarrësi për miratimin e aplikimit fillestar të Kredisë, dhe/ose ato që mund t'i paraqiten herë pas here gjatë çdo analize kredie të mëpasshme të kryer nga Kredidhënësi, janë / do të jenë të vërteta e të plota në çdo aspekt, në datën e paraqitjes së tyre tek Kredidhënësi.

11.1.2 Kredimarrësi ka marrë të gjithë informacionin dhe sqarimet e nevojshme para-kontraktore, në lidhje me kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshje.

11.1.3 Kjo Marrëveshje është lidhur lirisht mes Kredimarrësit dhe Kredidhënësit dhe përmban detyrime të vlefshme dhe të zbatueshme ndaj Kredimarrësit dhe personave të tjerë që, sipas ligjit, heqin të drejta prej tij.

11.1.4 Në Datën e Lidhjes, Kredimarrësi nuk gjendet nën ndonjë procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm apo falimentimi dhe se kjo procedura nuk kanë gjasa të ndodhin dhe se Kredimarrësi do të njoftojë menjëherë Kredidhënësin mbi ndonjë rrethanë që mund të çojë në nisjen ndaj Kredimarrësit, të ndonjë procedure të ekzekutimit të detyrueshëm apo falimentimi.

11.1.5 Kredimarrësi do të njoftojë menjëherë Kredidhënësin mbi ndonjë rrethanë që mund të krijojë ndonjë rrezik për një zvogëlim/humbje të ndjeshme të të ardhurave të deklaruara prej tij/saj gjatë aplikimit për kredi, apo gjatë çdo analize kredie të mëpasshme të kryer nga Kredidhënësi.

11.1.6 Kredimarrësi do të njoftojë menjëherë Kredidhënësin mbi çdo ndryshim në adresën e deklaruar prej tij, telefonin dhe e-mailin, dhe në çdo rast mban përgjegjësi për komunikimet e Kredidhënësit që nuk arrijnë apo kthehen mbrapsht nga shërbimi postar, telefonik apo e-mail, për pasaktësi të kontakteve dhe adresave të deklaruar prej tij.

12. Gjuha dhe Njoftimet

12.1 Kjo Marrëveshje lidhet në gjuhën Shqipe dhe çdo njoftim, kërkesë ose komunikim apo dokument tjetër që dërgohet në lidhje me këtë Marrëveshje ("Njoftimi") do të jetë në formë të shkruar dhe në gjuhën Shqipe.

12.2 Kredidhënësi mund të kryejë Njoftime në adresën fizike, në adresën e-mail apo në kontaktet e tjera të deklaruara nga Kredimarrësi më sipër në këtë Marrëveshje, apo në ndonjë adresë apo kontakt tjetër të Njoftuar nga Kredimarrësi herë pas here. Kredidhënësi mund të kryejë gjithashtu Njoftime për Kredimarrësin nëpërmjet mesazheve elektronike në Llogarinë Online.

12.3 Çdo Njoftim i kryer nga Kredidhënësi do të konsiderohet i kryer rregullisht ndaj Kredimarrësit, menjëherë: (a) pasi njoftimi kryhet me presence fizike në deget e ECFA sha tek Kredimarrësi; (b) pas dërgimit të mesazhit në adresën e-mail të Kredimarrësit; (c) me aksesimin e Llogarisë Online nga Kredimarrësi; (d) me postimin e njoftimit me shkrim në adresën e deklaruar nga Kredimarrësi; (e) me dërgimin e njoftimit SMS në numrin e telefonit të deklaruar nga e kredimarrësit, (f) me telefonaten e rregjistruar ne telefonin e deklaruar nga klienti

12.4 Çdo Njoftim i kryer nga Palët me shërbim postar, në adresën fizike të Palës tjetër, konsiderohet i kryer rregullisht ndaj marrësit, në ditën e dytë, pas datës së dorëzimit të Njoftimit tek shërbimi postar, pavarësisht momentit të marrjes nga marrësi.

12.5 Pavarësisht sa më sipër, çdo Njoftim i kryer me mjete të tjera komunikimi, i cili provohet të jetë kryer/marrë efektivisht, nuk do të konsiderohet i pavlefshëm vetëm për faktin se njoftimi apo komunikimi është dërguar në mënyra të ndryshme nga sa më sipër.

13 Zgjidhja e Marrëveshjes dhe Pasojat e Zgjidhjes

13.1 Nëse Kredimarrësi shkel detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshje, kjo shkelje do të përbëjë një "Rast Mospërmbushje" të kësaj Marrëveshje.

13.2 Nëse ka një Rast Mospërmbushje, Kredidhënësi mund t'i kërkojë Kredimarrësit me shkrim të korrigjojë Rastin e Mospërmbushjes ("Njoftimi i Korrigjimit"), brenda një afati të arsyeshëm (por jo më të shkurtër se 15 ditë), dhe mund të zgjidhë këtë Marrëveshje, nëpërmjet një njoftimi të shkruar drejtuar Kredimarrësit ("Njoftimi i Zgjidhjes"), nëse:

13.3 Rasti i Mospërmbushjes nuk korrigjohet brenda këtij afati; ose,

13.3.1 kur Rasti i Mospërmbushjes është i pamundur të korrigjohet, Palët nuk merren vesh brenda këtij afati për një kompensim të arsyeshëm.

13.4 Njoftimi i Zgjidhjes dërguar nga Kredidhënësi do të ketë si pasojë zgjidhjen e kësaj Marrëveshje, me efekt nga data e Njoftimit të Zgjidhjes, apo nga data e mëvonshme shënuar në Njoftimin e Zgjidhjes.

13.5 Palët bien dakord shprehimisht se Kredidhënësi ka të drejtë të zgjidhë menjëherë këtë Marrëveshje, pa ndjekur procedurën e mësipërme, nëpërmjet një Njoftimi Zgjidhjeje drejtuar Kredimarrësit, në rastet vijuese, të cilat Palët bien dakord se janë me interes thelbësor për Kredidhënësin:

13.5.1 Kredimarrësi nuk paguan Shumat e Pashlyera, sipas afateve të kësaj Marrëveshje; ose

13.5.2 Kredimarrësi është në shkelje të deklarimeve dhe garancive sipas Nenit 11 të kësaj Marrëveshje; ose

13.5.3 Kredimarrësi ka pësuar një zvogëlim/humbje të ndjeshme të të ardhurave të deklaruara prej tij/saj gjatë aplikimit për kredi, apo gjatë çdo analize kredie të mëpasshme të kryer nga Kredidhënësi;

13.5.4 Kredimarrësi nuk pranon ndryshimet e Njoftuara nga Kredidhënësi në Kushtet e Llogarisë Online si dhe në Politikën e Privatësisë;

13.5.5 Nëse Kredidhënësi nuk mund ta japë më Kreditin Kredimarrësit, në rast se llogaria bankare e Kredimarrësit është bllokuar apo mbyllur, dhe nuk mund të kryhet transferimi i fondeve, me kusht që Kredimarrësi të mos ketë hapur dot një llogari të re bankare e të mos ketë njoftuar rregullisht Kredidhënësin nëpërmjet Njoftimit;

13.5.6 Nëse Kredidhënësi ka identifikuar se Kredimarrësi është bërë një person i ekspozuar politikisht;

13.5.7 Nëse Kredidhënësi është deklaruar i paaftë për të vepruar me zotësi të plotë ligjore dhe biznesi.

13.6 Kredimarrësi mund të zgjidhë këtë Marrëveshje nëpërmjet një Njoftimi Zgjidhjeje të shkruar drejtuar Kredidhënësit, në rast të zvogëlimit të Limitit sipas Nenit 5.2, të një refuzimi disbursimi sipas Nenit 6.3, apo gjatë periudhës së përcaktuar sipas Nenit 15.3 të kësaj Marrëveshje, nëse Kredimarrësi vendos të mos pranojë ndryshimin e Njoftuar nga Kredidhënësi sipas Nenit 15.3.

13.7 Secila Palë mund të zgjidhë këtë Marrëveshje nëpërmjet një Njoftimi Zgjidhjeje të shkruar drejtuar Palës tjetër, të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara, pa qenë i nevojshme përcaktimi i shkakut të zgjidhjes.

13.8 Kredimarrësi nuk mund të zgjidhë këtë Marrëveshje përveçse në rastet e parashikuara më sipër sipas këtij Neni.

13.9 Në çdo rast të zgjidhjes së kësaj Marrëveshje, afati i pagesës së Shumave të Pashlyera që Kredimarrësi i detyrohet Kredidhënësit do të përshpejtohet, duke u bërë të detyrueshme për t'u paguar nga Kredimarrësi, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të zgjidhjes, pavarësisht afateve të rena dakord më parë.

13.10 Zgjidhja e kësaj Marrëveshje nuk do të çenojë zbatueshmërinë e parashikimeve sipas Neneve 8, 9, 12, 14, 16, 17 dhe 18 të kësaj Marrëveshje, të cilat do t'i mbijetojnë zgjidhjes së kësaj Marrëveshje.

14. Ligji i Zbatueshëm dhe Gjykatat Kompetente

14.1 Kjo Marrëveshje do të rregullohet nga dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

14.2 Secila Palë bie dakord dhe pranon në mënyrë të përvokueshme se çdo mosmarrëveshje, padi, masë sigurimi, urdhër ekzekutimi apo procedure tjetër gjyqësore, që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, ("Mosmarrëveshja") do të zgjidhet në mënyrë ekskluzive nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

14.3 Palët bien gjithashtu dakord se nisja apo vazhdimi i një Mosmarrëveshje nuk do të përbëjë një shkak të vlefshëm për ndërprerjen e zbatimit të kësaj Marrëveshje dhe nuk do të çlirojë Kredimarrësin nga vazhdimi i përmbushjes së detyrimeve të marra përsipër nëpërmjet kësaj Marrëveshje.

15. E Gjithë Marrëveshja, Ndryshimet

15.1 Kjo Marrëveshje, përfshirë deklaratat hyrëse dhe dokumentat bashkëlidhur, përfaqëson marrëveshjen finale dhe të plotë të Palëve në lidhje me objektin e saj dhe shfuqizon e zëvendëson çdo Marrëveshje, marrëveshje paraprake apo diskutime të mëparshme, qofshin këto verbale ose me shkrim, ndërmjet po këtyre Palëve në lidhje me të njëjtin objekt.

15.2 Dispozitat e kësaj Marrëveshje nuk mund të ndryshohen përveçse me anë të një marrëveshje të shkruar (e cila mund të përfshijë dhe marrëveshje

në formë elektronike) lidhur rregullisht nga Palët, dhe çdo ndryshim i tillë do të prodhojë efekte duke filluar nga data e nënshkrimit nga Palët (përveçse kur data e hyrjes në fuqi është parashikuar ndryshe).

15.3 Pa çënuar parashikimet e mësipërme, Palët bien dakord se Kredidhënësi, nëpërmjet një Njoftimi drejtuar Kredimarrësit, ka të drejtë të ndryshojë komisionet për shërbimet ndihmese opsionale të cilat nuk janë pjesë e kushteve kryesore të Kontrates së Kredisë dhe nuk janë të detyrueshme për klientin apo përfitimin e kredisë ato do të jenë të zbatueshme ndaj një shume të Disbursuar më parë, nëse në vijim të Disbursimit, ndryshohet Tabela e Interesit dhe e Komisioneve. Nëse mbas 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, Klienti nuk përgjigjet, atëherë njoftimi do të konsiderohet i miratuar. Në këto raste, (i) ndryshimi i Njoftuar nga Kredidhënësi nuk do të ketë efekt ndaj Kredimarrësit përpara skadimit të një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e Njoftimit të Kredidhënësit dhe (ii) gjatë këtij afati 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, Kredimarrësi ka të drejtë t'i Njoftojë Kredidhënësit zgjidhjen e Marrëveshjes, sipas Nenit 13.5.

15.4 Nëse Kredimarrësi nuk i paraqet Kredidhënësit një Njoftim Zgjidhjeje, sipas Nenit 13.5, brenda një afati 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh të cituar më sipër, atëherë ndryshimi i Interesit dhe Komisioneve të Njoftuara nga Kredidhënësi, do të fillojë të zbatohet duke nisur nga përfundimi i këtij afati.

15.5 Duke nënshkruar këtë kontratë, Klienti deklaron se është vënë në dijeni, i kupton dhe bie dakord me faktin që duhet të njihet në mënyrë të vazhdueshme me Tabelën e Interesit dhe Komisioneve të publikuar në ambientet e Kredidhënësit dhe në faqen e tij në internet për t'u njohur mbi ndryshimet e mundshme të termave dhe kushteve të kësaj kontrate apo elementeve të tjera që mund të kenë impakt mbi këtë kontratë.

16. Kalimi

16.1 Të drejtat dhe detyrimet e Kredimarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje nuk mund t'i kalohen një personi të tretë, pa marrë pëlqimin paraprak me shkrim të Kredidhënësit për pranimin e këtij personi të tretë si debitor i ri, dhe ky pëlqim do të jetë në diskrecionin e vetëm të Kredidhënësit, përveç rasteve kur detyrimi i Kredimarrësit i kalohet personave të tretë sipas rregullave të trashëgimisë ligjore.

16.2 Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Kredimarrësi i jep që tani pëlqimin e tij të parevokueshëm Kredidhënësit, për t'i kaluar të drejtat dhe/ose detyrimet ndaj Kredidhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje një personi të tretë.

16.3 Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Kredimarrësi jep gjithashtu, pëlqimin e tij të parevokueshëm, që Kredidhënësi të japë apo kalojë, plotësisht apo pjesërisht, në çdo formë, të drejta pagese mbi shumat e arkëtueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, në favor të çdo pale të tretë, pa njoftuar Kredimarrësin, dhe Kredimarrësi, për as kohë nuk ka marrë njoftim mbi ndonjë kalim sipas këtij neni, mbetet i detyruar të kryejë pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje, drejtpërdrejt ndaj Kredidhënësit.

17. Titulli Ekzekutiv

17.1 Kjo Marrëveshje përbën një akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe si e tillë është titull ekzekutiv i detyrueshëm për Kredimarrësin

17.2 Nëse Kredimarrësi nuk paguan Shumat e Pashlyera, sipas kushteve dhe brenda afateve të përcaktuara sipas kësaj Marrëveshjeje, atëherë Kredidhënësi i lind e drejta të nisë procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm për Kredimarrësin, pa çënuar të drejtën e Kredidhënësit për të marrë masat e tjera në dispozicion të tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe/ose sipas ligjit.

18. Të Ndryshme

18.1 Kredidhënësi nuk do të konsiderohet se ka hequr dorë nga ndonjë e drejtë që i njihet sipas kësaj Marrëveshjeje, apo sipas ligjit, dhe Kredimarrësi nuk do të konsiderohet i çliruar nga detyrimi për të përmbushur plotësisht këtë Marrëveshjeje, përveçse kur një dorëheqje e tillë është bërë shprehimisht me shkrim nga Kredidhënësi.

18.2 Çdo vonesë nga ana e Kredidhënësit në ushtrimin e ndonjë të drejte që i njihet sipas kësaj Marrëveshjeje, apo sipas ligjit, nuk do të pengojë ushtrimin e mëvonshëm të kësaj të drejte, apo ndjekjen e masave ligjore, për sa kohë këto të drejta nuk janë parashikuar sipas ligjit.

18.3 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje konstatohet apo deklorohet nga gjykata kompetente si e pavlefshme apo e pazbatueshme, atëherë kjo nuk do të prekë vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e dispozitave të tjera të Marrëveshjes, dhe dispozita e prekur do të quhet e zëvendësuar automatikisht me një dispozitë të vlefshme, e cila ndjek, për sa është e mundur, qëllimin origjinal të Palëve. Zëvendësimi automatik i dispozitës sipas këtij parashikimi do të jetë pasoja e vetme mes Palëve, nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje konstatohet apo deklorohet si e pavlefshme apo e pazbatueshme

NË PRANI TË NJËRA TJETRËS, Palët lidhin këtë Marrëveshjeje në 2 (dy) kopje origjinale, një për secilën Palë, në datën e shënuar më sipër.

Për Kredidhënësin:

Kredimarrësi

[Emër, Mbiemër, Firmë]
Përfaqësues i Autorizuar

[emri, mbiemri dhe nënshkrimi]

Në bazë të Nenit 686 të Kodit Civil, Kredimarrësi deklaron se është në dijeni të plotë të parashikimeve sipas Neneve 5.2, 6.3, 8, 9, 13, 14, 15.3, 16 dhe 17 të kësaj Marrëveshjeje, dhe i miraton ato veçmas nëpërmjet këtij nënshkrimi. Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Kredimarrësi, gjithashtu deklaron se është në dijeni të plotë dhe pranon parashikimet e Tabelës së Interesit dhe Komisioneve, Kushteve të Llogarisë Online dhe të Politikës së Privatësisë të Kredidhënësit, siç janë në fuqi në Datën e Lidhjes. Çdo ndryshim i këtyre dokumenteve do t'i njoftohet Kredimarrësit për miratim, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Kredimarrësi:

ANEKS 1 - Marrëveshje Kredie Konsumatore Sipas Aplikimit
Nr:73XXXXXX, Datë 08.09.2025 Pjesë e Marrëveshjes së Linjës
së Kredisë pa afat Nr: AGXXXXXXX

INFORMACION MBI PALËT

KREDIDHËNËS

Emri i Shoqërisë: ECFA Sh.a Numri i Regjistrimit: L71610009A
Selia: Rruga "Muhamet Gjollësja", Ndertesa Tirana Ring Center, Nr. 8, Kati i 9-te, Tirane, Albania
Adresa e-mail: info@kredo.al
Telefon: +355 44 500 600
Vendi i ofrimit: Rr: Kristaq Rama perballe Stacionit te Trenit,-, Durres

KREDIMARRËS

Emër, mbiemër:
Emri i babait:
Numri personal i identifikimit:
Letërnjoftimi/Pasaporta: ID Card
Adresa:
Adresa e-mail:
Telefon: +(355)

KUSHTET E SHUMËS SË KREDISË

KREDI NR: LXXXXXXX

- 1. Afati i Kredisë
Kredia me Këste: 36 këste mujore
- 2. Limitet
 - 2.1. Limiti i Kredisë së aprovuar: 188,000.00 ALL
 - 2.2. Shuma e Kredisë: 120,000.00 ALL
- 3. NEI, Norma efektive e interesit: 62.01 %
- 4. Norma nominale mujore e interesit : 4.10 % ne muaj, 111460.00 ALL
- 5. Totali i kostos se kredise: 245860.00 ALL
- 6. Grafiku i Pagesës (vlerat në lekë)

Nr	Datë	Principal:	Interes:	Detyrimi mujor
1	08.10.2025	1,580.00	4,850.00	6,430.00
2	08.11.2025	1,480.00	4,950.00	6,430.00
3	08.12.2025	1,700.00	4,730.00	6,430.00
4	08.01.2026	1,620.00	4,810.00	6,430.00
5	08.02.2026	1,680.00	4,750.00	6,430.00
6	08.03.2026	2,210.00	4,220.00	6,430.00
7	08.04.2026	1,850.00	4,580.00	6,430.00
8	08.05.2026	2,070.00	4,360.00	6,430.00
9	08.06.2026	2,010.00	4,420.00	6,430.00
10	08.07.2026	2,230.00	4,200.00	6,430.00
11	08.08.2026	2,190.00	4,240.00	6,430.00
12	08.09.2026	2,280.00	4,150.00	6,430.00
13	08.10.2026	2,510.00	3,920.00	6,430.00
14	08.11.2026	2,480.00	3,950.00	6,430.00
15	08.12.2026	2,710.00	3,720.00	6,430.00
16	08.01.2027	2,700.00	3,730.00	6,430.00
17	08.02.2027	2,810.00	3,620.00	6,430.00
18	08.03.2027	3,270.00	3,160.00	6,430.00
19	08.04.2027	3,060.00	3,370.00	6,430.00
20	08.05.2027	3,290.00	3,140.00	6,430.00
21	08.06.2027	3,330.00	3,100.00	6,430.00
22	08.07.2027	3,560.00	2,870.00	6,430.00
23	08.08.2027	3,620.00	2,810.00	6,430.00
24	08.09.2027	3,770.00	2,660.00	6,430.00
25	08.10.2027	4,010.00	2,420.00	6,430.00

26	08.11.2027	4,090.00	2,340.00	6,430.00
27	08.12.2027	4,330.00	2,100.00	6,430.00
28	08.01.2028	4,440.00	1,990.00	6,430.00
29	08.02.2028	4,630.00	1,800.00	6,430.00
30	08.03.2028	4,930.00	1,500.00	6,430.00
31	08.04.2028	5,030.00	1,400.00	6,430.00
32	08.05.2028	5,280.00	1,150.00	6,430.00
33	08.06.2028	5,460.00	970.00	6,430.00
34	08.07.2028	5,710.00	720.00	6,430.00
35	08.08.2028	5,930.00	500.00	6,430.00
36	08.09.2028	6,150.00	260.00	6,410.00
			Total:	231,460.00

Vlerat rrumbullakosen në 10-she të plota, diferencat nëse ka pasqyrohen tek interesi.

Shtyrje date pagese: Afati maksimal i kësaj kredie mund të ndryshojë nëse palët e kësaj kontrate bien dakord për të shtyrë pagesën e kredisë përkundëjt pagesës së komisionit të shtyrjes prej 35 % mbi vlerën e detyrimit kontraktual të papaguar, të aplikueshëm për çdo muaj të shtyrjes së pagesës. Ne kredine me disa keste nje kest mund te shtyhet vetem njehere dhe pastaj duhet paguar per te mundesuar shtyrjen e kestit te radhes.

Kamatëvonesa: 2 % për çdo ditë vonese e përlogaritur mbi vlerën totale të principalit dhe interesit të papaguar në vonese.

Kamatëvonesa e papaguar nuk tejkalon 30% te principalit dhe interesit të papaguar.

Pagesat me para në dorë: Në rast të pagesës së detyrimeve me para në dorë, aplikohet 100 ALL për çdo pagesë të kryer në cash. Kjo kosto mund të ndryshohet herë pas here në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Kredisë dhe ligjit dhe do të zbatohet në bazë të Tabelës së Interesit dhe Komisioneve në fuqi.

Komisioni I Lëvrimit me para në dorë: Ju mund te kerkoni levrim te kredise me para ne dore ne nje nga deget e institucionit ose prane Western Union apo Easy Pay, dhe jo ne llogarine tuaj bankare (standard i kushteve te kredise) kundrejt nje komisioni shtese prej 8.00 % te vleres se levruar.

Komisioni I Lëvrimit të menjëhershëm: Ju mund te kerkoni levrim te menjehershem te kredise dhe jo pas 14 diteve (standard i kushteve te kredise) kundrejt nje komisioni shtese prej 14.00% te vleres se levruar.

Nëpërmjet nënshkrimit të këtij Aneksi 1, pjesë e pandarë e Marrëveshjes se Linjes se kredise pa afat, Kredimarrësi deklaron posaçërisht se ai/ajo është plotësisht në dijeni dhe pranon kushtet e këtij Aplikimi, Marrëveshje, Koston e Kredisë, Tabelen e Interesave dhe Komisioneve sic janë ato në fuqi në Datën e Nënshkrimit.

Datë: 08.09.2025

Datë: 08.09.2025

Për Kredidhënësin:

Kredimarrësi:

[Emër, Mbiemër, Firmë]
Përfaqësues i Autorizuar

[emri, mbiemri dhe nënshkrimi]

MENYRA E LEVRIMIT TE KREDISE

Në bazë të Aneksit 1 për kredinë Nr. LXXXXXXX, sipas Aplikimit Nr:73XXXXXX, Datë 08.09.2025 pjesë e Marrëveshjes së Linjes së Kredisë pa afat Nr: AGXXXXXXX

Banka:

Llogaria bankare:

Ky formular kërkesë specifikon kërkesën për disbursimin e shumës përkatëse për këtë kredi nëpërmjet një prej metodave alternative të mëposhtme:

- ☐ Konfirmoj lëvrimin në llogarinë bankare me të dhënat e mësipërme.
- ☒ Kërkoj lëvrim me para në dorë pranë degëve të ECFA Sh.a.
- ☐ Kërkoj lëvrim me para në dorë pranë degëve të Western Union.
- ☐ Kërkoj lëvrim me para në dorë pranë degëve të Easy Pay.

Me anë të kësaj kërkesë, unë konfirmoj që kuptoj që me zgjedhjen e mënyres së lëvrimit me para në dorë në një prej degëve të ECFA Sh.a, apo Western Union apo Easy Pay, do të ngarkohet një kosto shtesë si Komision Lëvrimi me para në dorë në masën 8.00 % të vlerës së lëvruar, vlerë 9600.00 ALL Gjithashtu, konfirmoj që kuptoj që ky komision është i pagueshëm në momentin e disbursimit dhe i parimbursueshëm apo i zbritshëm në rast tërheqje nga Kredia apo një mbyllje të parakohshme të kredisë. Ky komision, në bazë të rregullores së Bankës së Shqipërisë nr 48 mbi Kredinë Konsumatore dhe Hipotekore, neni 15/1, është i pagueshëm në momentin e lëvrimit të kredisë, prandaj konfirmoj me poshtë menyren e pagesës:

Ky formular kërkesë specifikon dhe kërkesën për kohën e lëvrimit të shumës përkatëse të kredisë si vijon:

- ☒ Menjëherë pas nënshkrimit të Aneksit 1.
- ☐ Pas 14 ditëve pune sipas klauzulës 6.4 të marrëveshjes së linjës së kredisë pa afat.

Përmes kësaj kërkesë, konfirmoj se kuptoj që duke zgjedhur lëvrim të menjëhershëm të shumës së kredisë do të ngarkohet një kosto shtesë si Komision i Lëvrimit të Menjëhershëm në shumën prej 14.00% të vlerës së lëvruar, vlerë 14400.00 ALL. Gjithashtu, konfirmoj se kuptoj që ky komision është i pagueshëm në kohën e disbursimit dhe nuk rimbursohet ose nuk zbritet në rast tërheqjeje nga Kredia ose mbylljeje të parakohshme të kredisë. Ky komision, bazuar në Rregulloren Nr. 48 të Bankës së Shqipërisë për Kreditë Konsumatore dhe Hipotekare, Neni 15/1, është i pagueshëm në kohën e lëvrimit të kredisë, prandaj konfirmoj metodën e pagesës si më sipër:

- ☐ Paguhet nga kredimarrësi më 08.09.2025 përpara disbursimit
- ☒ Mbahet si pagesë nga vlera e kredisë që lëvrohet

Rrjedhimisht vlera për tu lëvruar pas zgjedhjeve të mësipërme është 96000.00 ALL

Datë: 08.09.2025

Kredimarrësi:

[emri, mbiemri dhe nënshkrimi]

CHECK LIST E DOKUMENTACIONIT NE DOSJEN FIZIKE TE DHENA TE KLIENTIT

Emer Atesi Mbiemer:	
Numri I Kontrates (AG):	AGXXXXXXXX
Numri i Kredise (L):	LXXXXXXXX
Numri i aplikimit:	73XXXXX
Data e Disbursimit:	08.09.2025
Tipi I klientit (I ri/Perserites/I refuzuar(anulluar)):	

DOKUMENTACIONI

TIPI I DOKUMENTACIONIT	ZGJIDH DOK QE JANE NE DOSJE NESE NDODHET NE DOSJE
Klauzola Pelqimi Paraprak:	
Formulari I Aplikimit:	•
	•
Kontrata e Kredise/Amendament	•
AML	•